



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

STRATEGJIA AFATMESME

2015-2017

DHE

PLANI I VEPRIMIT

Përmbajtja e lëndës

Hyrje	3
Kreu I – Analiza e situatës aktuale	4
1.1 Parimet bazë të funksionimit dhe struktura e Prokurorisë Shqiptare	4
1.2 Zhvillimet institucionale në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar	6
Kreu II - Objektivat.....	9
2.1 Rritja e efektivitetit të hetimit	9
2.2 Forcimi i pavarësisë dhe rolit të Prokurorisë	11
2.3 Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë	13
2.4 rritja e transparencës në komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun	13
Kreu III – Burimet financiare.....	15
3.1 Buxheti i Shtetit	15
3.2 Projektet me donatorët e huaj	15
Kreu IV - Monitorimi dhe Raportimi	17
4.1 Monitorimi	17
4.2 Raportimi	17
Kreu V – Plani i Veprimit	18 - 27

HYRJE

Strategjia afatmesme e Prokurorisë Shqiptare për periudhën 2015 – 2017 është e bazuar në përmbushjen me sukses të detyrimeve të saj kushtetuese dhe ligjore për ndëshkueshmërinë pa kompromis të të gjitha veprave penale, në të njëjtën kohë, duke garantuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Ajo ka për qëllim të paraqesë në mënyrë të strukturuar objektivat dhe planin e veprimit për periudhën në fjalë. Në fokus të kësaj strategjie mbetet ndëshkimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, si fenomene që mbajnë peng zhvillimin e vendit dhe shoqërisë, si dhe bëhen pengesë për procesin integruar të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Në funksion të këtij qëllimi madhor, kjo strategji afatmesme parashikon objektiva konkrete, të matshme dhe të arritshme, të cilat synojnë maksimalizimin e standardeve të procedimit, rritjen dhe forcimin e profesionalizmit dhe integritetit të trupës së prokurorëve, përmirësimin dhe modernizimin e kapaciteteve teknike e teknologjike, mbrojtjen dhe fuqizimin e pavarësisë së institucionit, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet ligj-zbatuese partnere shqiptare dhe të huaja.

Kjo strategji është hartuar duke mbajtur parasysh performancën, arritjet dhe mangësitë e konstatuara në punën e organit të akuzës gjatë viteve të fundit, domosdoshmërinë e përmirësimit sasior dhe cilësor të performancës në përputhshmëri me zhvillimet konkretete të vendit, si dhe me rekomandimet e Progres Raportit 2014 për Shqipërinë dhe dokumentet strategjike kombëtarë të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

KREU I.

ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

1.1 Parimet bazë të funksionimit dhe struktura e Prokurorisë Shqiptare

1.1.1 **Parimet.** Prokuroria është organ kushtetues, organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me dispozitat e pjesës së dhjetë të Kushtetutës “Prokuroria”, ku janë parashikuar parimet e funksionet e saj si organi që ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. Kushtetuta përcakton se prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar dhe në ushtrimin e kompetencave të tyre u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe Ligjeve.

Misioni i Prokurorisë është t’i shërbejë publikut duke proceduar veprat penale me përgjegjësi, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, të mbrojtë të drejtat e individit dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë për të forcuar zbatimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës.

1.1.2 **Qëllimi.** Strategjia afatmesme e Prokurorisë Shqiptare 2015 - 2017 synon përmbushjen me sukses të detyrimeve të saj kushtetuese dhe ligjore për ndëshkueshmërinë pa kompromis të të gjitha veprave penale, duke garantuar në të njëjtën kohë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Në fokus të kësaj strategjie mbetet ndëshkimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, si fenomene që mbajnë peng zhvillimin e vendit dhe shoqërisë, si dhe bëhen pengesë për procesin integruar të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në funksion të këtij qëllimi madhor, kjo strategji afatmesme parashikon objektiva konkrete, të matshme dhe të arritshme, të cilat synojnë maksimalizimin e standardeve të procedimit, rritjen dhe forcimin e profesionalizimit dhe integritetit të trupës së prokurorëve, përmirësimin dhe modernizimin e kapaciteteve teknike e teknologjike, mbrojtjen dhe fuqizimin e pavarësisë së institucionit, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese partnere shqiptare dhe të huaja.

Arritja e këtij qëllimi është e lidhur ngushtë me përcaktimin e detyrave të çdo strukture të prokurorisë, koordinimin dhe bashkëpunimin efikas ndërmjet tyre dhe me partnerët vendas e të huaj, rritjen e pavarësisë, integritetit dhe transparencës së prokurorisë, shtimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e kapaciteteve tekniko –profesionale.

1.1.3 **Struktura.** Ligji organik nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, detajon aspektet e organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë Shqiptare. Prokuroria i ushtron funksionet nëpërmjet prokurorëve.

Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si strukturë e centralizuar, ku përfshihen zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorisë dhe Prokuroritë pranë sistemit gjyqësor.

Këshilli i Prokurorisë është organ kolegjal me funksione këshillimore, në ndihmë të Prokurorit të Përgjithshëm.

Organet e prokurorisë janë:

- Prokuroria e Përgjithshme e Republikës;
- Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe 6 prokuroritë pranë gjykatave të apelit;
- Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe 22 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.

1.1.4 **Burimet njerëzore.** Numri total i punonjësve në sistemin e Prokurorisë, miratuar me ligjin 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015” është 848.

Numri i prokurorëve të miratuar me dekret të Presidentit të Republikës është 330, i njëjtë prej vitit 2002. Ndërkohë ngarkesa dhe dinamika e punës së prokurorisë ka ardhur vazhdimisht në rritje nga viti në vit.

Në rang vendi veprojnë aktualisht 326 prokurorë, ndër të cilët 284 prokurorë pranë gjykatave të shkallës së parë, 25 prokurorë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë pranë Gjykatës së Lartë.

Në rang vendi veprojnë aktualisht 154 oficerë të policisë gjyqësore, ndër të cilët 135 oficerë të policisë gjyqësore pranë gjykatave të shkallës së parë, 1 oficer i policisë gjyqësore pranë gjykatave të apelit dhe 18 oficerë të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Në Prokurorinë e Përgjithshme ushtrojnë funksionet 9 ndihmës ligjorë dhe janë parashikuar të jenë 10 të tillë.

Në Prokurorinë e Përgjithshme është ngritur struktura e shërbimeve të ekspertimit me përbërje 3 ekspertë, e cila pritet të bëhet efektive në një kohë të afert.

Shërbimet tekniko-administrative në Prokurorinë e Përgjithshme dhe shërbimet ndihmëse në prokuroritë e niveleve të tjera pranë sistemit gjyqësor kryhen nga nëpunës dhe punonjës të tjerë, numri i të cilëve është 355 në gjithë strukturën e Prokurorisë.

Vlerësimi i gjendjes aktuale dhe trendit në rritje të ngarkesës dhe pritshmërisë së punës së Prokurorisë nxjerrin në pah domosdoshmërinë e shtimit të burimeve njerëzore të Prokurorisë si me prokurorë ashtu edhe me personel ndihmës të specializuar.

1.1.5 **Manaxhimi i burimeve - konstatime.** Lidhur me efikasitetin e gjyqësorit, Progres Raporti 2014 nënvizon se: *“Burimet në dispozicion duhet të rishikohen dhe të shtohen, që të përballohet rritja e ngarkesës së punës në prokurori dhe gjykata”*.

Ligji nr.8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon në nenin 57/1 të tij se: “Prokuroria ka buxhet të pavarur që hartohet, administrohet e zbatohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”. Në bazë të legjislacionit në fushën e buxhetit tavanet buxhetore miratohen nga Ministria e Financave dhe Prokuroria paraqet nevojat e saj mbi tavanet buxhetore, të cilat nëse nuk merren në konsideratë nga Ministria e Financave mund të kërkojnë në Komisionin Parlamentar të Ligjeve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në raportin përfundimtar të auditimit të vitit 2012, ka rekomanduar për prokurorinë marrjen e masave për përmirësimin e nenit 57 më sipër, duke sugjeruar formulimin: “Prokuroria ka buxhet të pavarur i cili përballohet nga buxheti i shtetit dhe ka një kapitull të veçantë. Projekt-buxheti propozohet nga Prokurori i Përgjithshëm në komisionin parlamentar përgjegjës për financat publike, i cili paraqet në Kuvend në përputhje me ligjin për buxhetin.”.

Opinionin Nr.9/2014 i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Europianë drejtuar Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës në paragrafin 6.3 “Menaxhimi i burimeve”, parashikon:

“Sigurimi i burimeve organizative, financiare, materiale dhe njerëzore të mjaftueshme kontribuon në sigurimin e pavarësisë. Veçanërisht në kohë të vështira ekonomike, burime të mjaftueshme duhet të caktohen për të siguruar një shërbim. Në çdo rast, qoftë kur shërbimet e prokurorisë kanë ose nuk kanë autonomi menaxhimi, ato duhet të jenë të aktivizuara për të vlerësuar nevojat e tyre, të negociojnë buxhetet e tyre dhe të vendosin si të përdorin fondet e akorduara në mënyrë transparente, në mënyrë që të arrihen objektivat e drejtësisë së shpejtë dhe me cilësi”.

Raporti mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor, Pjesa e II “Shërbimi i Prokurorisë” (Strasbourg, 3 Janar 2011), miratuar nga Komisioni i Venecias në seancën plenare të 85^{-të}, në shkronjë “H” paragrafi 69 parashikon:

“H. 69. Si për gjyqtarët, paga në përputhje me rëndësinë e detyrës që kryen është thelbësore për një sistem eficient dhe të drejtë të drejtësisë penale. Një pagë e mjaftueshme është gjithashtu e nevojshme për të reduktuar rrezikun e korrupsionit të prokurorit”.

Zhvillimet institucionale në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar

Në fokus të veçantë të punës së Prokurorisë ka qenë dhe do të vijojë të mbetet lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ngritja dhe forcimi i strukturave hetimore, forcimi i kapaciteteve profesionale dhe forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe me partnerët

ndërkombëtarë kanë qenë hapat e ndërmarrja në adresim të rekomandimeve për një luftë efikase ndaj këtyre veprave penale. Kështu:

- 1.2.1 Në vitin 2007, u krijua **Njësia e Përbashkët Hetimore** në përbërje të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me përbërje prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore si dhe staf të specializuar të Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe inspektorë të Shërbimit Informativ Shtetëror. Njësia e Përbashkët Hetimore do të koordinonte hetimin e veprave penale të krimit ekonomik.

Në vitin 2009 u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet gjashtë institucioneve: Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurisë dhe Shërbimi Informativ Shtetëror. Bazuar në këtë Memorandum, me Urdhërin Nr.2014/2009 të Prokurorit të Përgjithshëm, u krijuan 7 Njësi të Përbashkëta Hetimore në Prokuroritë e Rrethit Tiranë, Shkodër, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë.

Në muajin Prill 2014 u krijua Njësia e Përbashkët Hetimore edhe në Prokurorinë e Rrethit Elbasan.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në vitin 2014 ishte transferimi i juridiksionit për katër vepra penale të korrupsionit nga Njësitë e Përbashkëta Hetimore në Gjykatën e Krimeve të Rënda me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale me Ligjin 21/2014. Në vijim të këtyre ndryshimeve, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm u krijua pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krime të Rënda seksioni i Hetimit të korrupsionit dhe pasurive.

Në Prokurorinë e Përgjithshme, në vitin 2014 është ngritur Drejtoria e Kontrollit të Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit (Task-Forcë) për kontrollin e hetimit të korrupsionit, krimit ekonomik dhe hetimit pasuror, në përbërje të të cilit funksionon edhe Sektori i Hetimit të krimit kibernetik.

- 1.2.2 Në vitin 2004 u krijua **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda**, bazuar në Ligjin Nr. 9110, dt.24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda”, kompetente për hetimin e krimeve më të rënda kundër jetës e lirisë së personit, rendit kushtetues, trafikëve të paligjshme të drogave, armëve e personave, krimin e organizuar dhe terrorizimin. Nga viti 2014 në kompetencën e saj janë edhe veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv të zyrtarëve të lartë, përfaqësuesve të zgjedhur vendorë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

Gjithashtu, në kompetencë të kësaj Prokurorie është edhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit përmes konfiskimit të pasurisë së personave të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik si rezultat i pjesëmarrjes në veprimtari të dyshuar kriminale (në krimin e organizuar, trafikë dhe korrupsion), në përputhje me Ligjin Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

1.2.3 **Ndryshimet ligjore**, institucionale, forcimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore, kanë dhënë rezultate në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Janë rritur ndjeshëm kallzimet/referimet e ardhura në Prokurori për raste të veprave korruptive. Treguesit statistikorë tregojnë një rritje prej 31 % të kallzimeve e referimeve të paraqitura në vitin 2014, krahasuar me ato të vitit 2013. Procedimet penale të regjistruara për këto vepra nga Prokuroria kanë ardhur gjithashtu në rritje prej 35 %, në krahasim me vitin 2013. Ndërkaq kemi një rritje prej 60 % të procedime të dërguara për gjykim, në krahasim me vitin 2013.

Në lidhje me të pandehurit, për këtë grup veprash penale, vihet re një rritje prej 30 % e numrit të të pandehurve të regjistruar përkundrejt këtij totali në vitin 2013, si dhe një rritje prej 77 % të numrit të të pandehurve të cilët i janë dërguar gjyqit, përkundrejt vitit 2013.

Sa i përket krimit të organizuar, Prokuroria për Krime të Rënda në vitin 2014 ka regjistruar 13 procedime penale për nenin 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”, duke ngritur akuzë për 38 të pandehur.

Gjithashtu, gjatë vitit 2014 janë regjistruar 11 procedime penale për nenin 230 të Kodit Penal “Vepra me qëllime terroriste”.

KREU II

OBJEKTIVAT

2.1 Rritja e efektivitetit të hetimit. Objektivi kryesor i Prokurorisë Shqiptare mbetet rritja e efektivitetit të hetimit dhe vënia përpara përgjegjesisë penale të kujtdo që shkel ligjin. Përmbushja e këtij objektivi madhor kërkon domosdoshmërisht edhe realizimin e masave/veprimeve të poshtëshënuara:

2.1.1 **Rritjen e efektivitetit dhe decentralizimin e përgjimeve të komunikimeve elektronike.** Kjo do ta bëjë më efektiv përdorimin e përgjimit si mjet i kërkimit të provës dhe do të kufizojë numrin e personave që marrin akses në këtë informacion. Në funksion të këtij procesi synohet:

- Krijimi dhe funksionimi i strukturave të posaçme dhe të specializuara për kryerjen e përgjimit ambiantal dhe përgjimit të komunikimeve elektronike pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe pranë Njësi të Përbashkëta Hetimore;
- Blerja e një sistemi të avancuar bashkëkohor të përgjimit të komunikimeve elektronike;
- Pajisja e strukturave të mësipërme me mjete teknike bashkëkohore.

2.1.2 **Vënia në efencë dhe rritja e kapaciteteve të shërbimeve të ekspertimeve** pranë Prokurorisë së Përgjithshme, si p.sh. ekspert autoteknik, ekspert kontabël dhe vlerësues, ekspert të kibernetikës, etj., me funksione këshillimore për prokurorët për çështje që kërkojnë njohurit të thelluara dhe të posaçme teknike në fusha të caktuara. Ngritja e këtij shërbimi kërkon edhe trajnimin e përshtatshëm të këtyre ekspertëve me njohuri të përgjithshme mbi hetimin penal dhe veçanërisht me metodikat e hetimit të veprave të caktuara penale.

2.1.3 **Rritja e cilësisë së hetimit pasuror.** Për të luftuar krimin dhe korrupsionin është thelbësore të privohen kriminelët nga gëzimi i pasurive të fituara e krijuara prej tij dhe, në të njëjtën kohë, të parandalohet futja e pasurisë kriminale në veprimtari të tjera kriminale, në përfshirjen në financat shtetërore nëpërmjet investimeve publike dhe korrupsionit të shoqërisë. Në këtë drejtim synohet:

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet Prokurorive të Rretheve Gjyqësore që hetojnë veprat penale objekt i fushës së zbatimit të ligjit nr.10192/2009, i ndryshuar, me Prokurorinë për Krime të Rënda;
- Realizimi i analizave të posaçme mes strukturave të tjera ligjzbatuese, Prokurorisë dhe Gjykatës për Krime të Rënda;
- Shfrytëzimi i teknologjisë dhe kapaciteteve hetimore-financiare të institucioneve si tatime, dogana, banka etj;
- Rritja e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë;
- Rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme;

- Caktimi i ekspertëve kontabël në mbështetje të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të Njesisë së Hetimit Pasuror dhe trajnimi i përshtatshëm i tyre për metodat dhe mënyrat e hetimit pasuror.
- Rritja e hetimeve proaktive, me fokus të veçantë në hetimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar;

2.1.4 **Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional** në luftën kundër kriminalitetit të të gjitha formave e veçanërisht në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, synohet të arrihet nëpërmjet:

- Organizimit të trajnimeve të përbashkëta me policinë gjyqësore me synim përmirësimin e funksionimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe në policitë gjyqësore të institucioneve të tjera;
- Shkëmbimin e shpejtë të informacionit dhe përmirësimin e cilësisë së informacioneve dhe akteve procedurale;
- Realizimin e aksesit të Prokurorisë në bazat e të dhënave të institucioneve shtetërore;
- Realizimin e takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta me Policinë e Shtetit dhe institucionet që kanë një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e Njësive të Përbashkëta Hetimore;
- Raportimin 3-mujor të statistikave të konsoliduara dhe krijimin e historikut të hetimit e gjyqësorit të çështjeve të korrupsionit e krimit të organizuar;
- Sigurimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të policisë gjyqësore.

2.1.5 **Forcimi i luftës ndaj krimit kibernetik.** Ndryshimet teknologjike ditë-pas-dite dhe krimet e kryera me anë të kompjuterit po rriten në mënyrë të ndjeshme. Shumica e krimeve që përfshijnë teknologjitë e tjera të informacionit synojnë nxjerrjen e përfitimeve ekonomike nëpërmjet llojeve të ndryshme të mashtrimit dhe formave të tjera të krimit ekonomik. Kështu, sasi të mëdha të të ardhurave nga krimet gjenerohen dhe qarkullojnë në internet. Rrjedhimisht, forcimi i luftës ndaj krimit kibernetik shihet i lidhur ngushtë edhe me hetimet financiare të cilat duhet të drejtohen edhe në kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimet, dhe hetimin e pastrimit të parave në internet. Në këtë drejtim synohet:

- Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe logjistike të strukturave të hetimit të krimit kibernetik. Trajnimi i përshtatshëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, njohja me legjislacionin ndërkombëtar, shkëmbimi i eksperiencave më të mira ndërkombëtare të hetimit të krimeve kompjuterike;
- Forcimi i bashkëpunimit të njësive të luftës kundër krimit kompjuterik me strukturat e tjera shtetërore dhe ato private të cilat operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit;

- Caktimi i ekspertit kibernetik në mbështetje të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

2.1.6 **Rritja e shpejtësisë dhe efikasitetit të ndjekjes penale**, përveç masave të marra në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe ndryshimeve strukturore në sistemin e Prokurorisë, kërkon edhe shtimin e numrit të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, sekretarisë procedurale dhe administratës ndihmëse të Prokurorisë.

2.1.7 **Përmirësimi i infrastrukturës elektronike të Prokurorisë** dhe vënia në efikasitet të plotë e sistemit të “Manaxhimit të Çështjeve” (Case Management).

2.1.8 **Kryerja e analizave dhe studimeve për ecurinë e punës** në drejtim të goditjes së formave të ndryshme të korrupsionit dhe krimit të organizuar, efektivitetit të hetimit, përcaktimit të nevojave materialo-financiare për strukturat që operojnë në këtë drejtim dhe plotësimin e tyre. Krijimi apo rishikimi periodik i strukturave të Prokurorisë me qëllim rritjen e efektivitetit në hetim dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore në përputhje me nevojat e secilës Prokurori. Për këtë qëllim Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore do të kryejë analiza dhe studime periodike mbi ngarkesën dhe shpërndarjen e punës në sistemin e prokurorisë.

2.1.9 **Forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore**. Në këtë drejtim do të synohet:

- Trajnimi i prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore;
- Trajnimi i administratës mbështetëse të prokurorisë për të bërë më efikas shërbimet tekniko-administrative;
- Hartimi i një plani 2-vjeçar trajnimi pasi të identifikohen nevojat përkatëse;
- Krijimi i një bazë të dhënash për trajnimet që zhvillohen, stafin e trajnuar dhe materialet trajnuese;
- Publikimi i një Reviste periodike Shkencore, Kërkimore e Informative të Prokurorisë së Përgjithshme me bord editorial, e hapur për botime të studuesve të kërkimit shkencor në fushën e të drejtës penale.

2.1.10 **Forcimi i kontrollit të brendshëm** dhe rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet drejtorive në Prokurorinë e Përgjithshme me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore.

2.2 Forcimi i pavarësisë dhe rolit të Prokurorisë

Prokuroria Shqiptare është një organ kushtetues, organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me dispozitat e pjesës së dhjetë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Prokuroria”, ku janë parashikuar parimet e funksionet e saj si organi që ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Kushtetuta përcakton se prokuroria është një organ i centralizuar dhe në ushtrimin e kompetencave të tyre u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe Ligjeve. Mbetet një aspekt thelbësor garantimi i pavarësisë së saj institucionale si kusht vendimtar për të ushtruar kompetencat e

përcaktuara me ligj dhe jashtë ndikimeve dhe influencave të pushteteve të tjera. Nën këtë këndvështrim, vlerësojmë se realizimi i këtij objektivi do të arrihet nëpërmjet:

2.2.1 **Rritja dhe konsolidimi i integritetit të prokurorëve.** Lufta kundër krimit nuk mund të ketë sukses pa forcimin e integritetit dhe performancën e lartë të çdo prokurori. Sjellja dhe veprimtaria e prokurorit do të udhëhiqen nga Ligji dhe në respekt të Ligjit, si dhe të parimeve të Kodit të Etikës, për të rritur besimin e publikut te Prokuroria dhe shteti ligjor. Sistemi i vlerësimit të prokurorëve po ndikon në përmirësimin dhe zhvillimin e punës profesionale dhe organizative të tyre, por synohet në përmirësimin e mëtejshëm të tij për t'i shërbyer objektivisht ngritjes në detyrë dhe karrierës profesionale. Në këtë drejtim do të kërkohet:

- Përmirësimi i sistemit të vlerësimit të punës dhe profesionalizmit të prokurorëve;
- Realizimi i vlerësimeve objektive;
- Përfshirja në Sistemin e Vlerësimit të elementëve objektivë të vlerësimit të etikës dhe integritetit të prokurorit;
- Zhvillimi i trajnimeve periodike vjetore mbi çështje të etikës.

2.2.2 **Përmirësimi të statusit të prokurorëve:**

- Përmirësimi i pagave dhe statusi i prokurorit;
- Analiza dhe standardizimi i të gjitha privilegjeve që duhet të gëzojnë prokurorët për shkak të detyrës dhe pas përfundimit të saj;
- Përmirësimi i kushteve dhe mjediseve të punës në disa prokurori të vendit;

2.2.3 **Organizimi i mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve** 2 herë në vit, për të formalizuar dhe standardizuar rolin, punën dhe qëndrimet e Prokurorisë;

2.2.4 **Forcimi i rolit të Këshillit të Prokurorisë**, veçanërisht në lidhje me çështjet e karrierës së prokurorit dhe në mirë-administrimin e prokurorisë, do të arrihet nëpërmjet:

- Implementimit të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë”, të ndryshuar;
- Implementimit të rregullores “Për sistemin e vlerësimit të Prokurorëve”;
- Implementimit të udhëzimit për “Procedurën e konkurrimit të kandidatëve për prokurorë që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë apo oficerë të policisë gjyqësore”, etj.

2.2.5 **Përmirësimi dhe zbatimi me rigorozitet dhe efektivitet i kuadrit ligjor.** Prokuroria në mënyrë të vazhdueshme ka dhënë kontributin e saj në reformën ligjore, për shtesa e ndryshime në ligje të ndryshme të sistemit të drejtësisë penale dhe organizimit dhe funksionimit të institucioneve të përfshira në këtë sistem. Me synim rritjen e efikasitetit në sistemin e drejtësisë penale shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, Prokuroria do të kontribuojë në këto drejtime:

- Identifikimin e mangësive dhe pengesave në ligjin material dhe atë procedural;
- Pjesëmarrjen në grupe pune për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale;

- Pjesëmarrjen në diskutime gjithpërfshirëse me prokurorët mbi propozimet për ndryshime në kuadrin ligjor penal e procedural penal dhe identifikimin e nevojave për përmirësim.
- Realizimin e analizave studimore mbi zbatimin dhe problematikat kryesore në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar dhe hetimit pasuror;
- Identifikimin e problematikave dhe unifikimin e politikës së ndjekjes penale në hetim dhe në gjykim, nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm.

2.3 Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë

Marrëdhëniet juridiksionale ndërmjet Institucionit të Prokurorisë Shqiptare dhe agjencive ligjzbatuese ndërkombëtare në fushën penale janë zgjeruar ndjeshëm, veçanërisht vitet e fundit. Kjo tendencë rritjeje lidhet me faktin se veprimtaria kriminale në përgjithësi dhe krimi i organizuar në veçanti kanë kaluar kufijtë nacionalë, duke u bërë gjithnjë e më shumë problem rajonal e global. Synimet kryesore në bashkëpunimin ndërkombëtar do të arrihen nëpërmjet këtyre masave:

2.3.1 Rritjes së shpejtësisë, cilësisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar;

- Vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta me institucionet homologe;
- Rritjen në mënyrë të ndjeshme të shkëmbimit të informacionit me autoritetet homologe të huaja, në kuadër të procedimeve penale;

2.3.2 Rritjen e bashkërendimit me institucionet dhe agjencitë e huaja ligjzbatuese;

- Ngritjen e skuadrave të përbashkëta hetimore;
- Organizimin e trajnimeve për krijimin dhe funksionimin e skuadrave të përbashkëta hetimore.

2.3.3 Rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për të identifikuar, ngrirë, sekuestruar e konfiskuar asetet kriminale;

- Organizimi i trajnimeve për njohjen me instrumentat ndërkombëtare në këtë fushë;
- Shkëmbimin e eksperiencave më të mira.

2.4 Rritja e transparencës në komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun

Prokuroria Shqiptare planifikon që marrëdhëniet me publikun t'i trajtojë në disa dimensione: bashkëpunim në luftën kundër krimit, transparencë për të rritur besimin e publikut te Prokuroria dhe veprimtari për edukimin e shoqërisë dhe profesionistëve të ardhshëm të drejtësisë, me synim njohjen e ligjit dhe parandalimin e kriminalitetit. Synimet kryesore do të arrihen nëpërmjet këtyre masave:

- 2.4.1 *Akses në informacion në përputhje me ligjin*, përditësimin e faqjes zyrtare të internetit të Prokurorisë me aktivitetet më të fundit të kryera, zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me mediat, etj;
- 2.4.2 *Fushata ndërgjegjësuese mediatike* për fenomenin e korrupsionit, krimit të organizuar, narkotikëve, rekrutimeve si ‘luftëtarë të huaj’, etj.;
- 2.4.3 *Fushatë ndërgjegjësuese me studentët e Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Ekonomisë* (publike dhe private). Do të kërkohet mbështetja dhe bashkëpunimi i OPDAT dhe projekteve të tjera që mbështesin prokurorinë në punën e saj, për të realizuar:
- Leksione të hapura periodike (marrëveshje bashkëpunimi me rektoratin ose dekanatet);
 - Konkurse mbi tema të ndryshme në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar;
 - Në bashkëpunim me Fakultetet e Drejtësisë, përfshirja e studentëve në realizimin e studimeve të ndryshme, në interes të Prokurorisë Shqiptare.

KREU III

BURIMET FINANCIARE

3.1 Buxheti i Shtetit

Në identifikimin e nevojave për burime financiare, vendin kryesor e zë Buxheti i Shtetit (afatshkurtër dhe afatmesëm) për Prokurorinë.

Tavanet përgatitore të PBA, miratuara me Ligjin për Buxhetin e vitit 2015, të shprehura në milionë lekë janë si më poshtë:

Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Totali	Totali	Totali
1.688	1.564	1.564

3.2 Projektet me donatorët e huaj.

Gjithashtu, një vend të rëndësishëm në mbështjen financiare të Prokurorisë zënë projektet e huaja, donatorë dhe partnerë të tjerë të Prokurorisë Shqiptare.

Tabela e mëposhtme siguron një informacion të përmblëdhur mbi projektet me financim të huaj nga të cilat përfiton Prokuroria e Përgjithshme:

PROJEKTI	STATUSI	FINANCIMI
Modernizimi i Sistemit të Drejtësisë Shqiptare: ngritja e sistemit kompjuterik të Menaxhimit të Çështjes, IPA 2010	Në proces implementimi	2.800.000 Euro
Projekti EURALIUS IV, “Konsolidimi i sistemit të drejtësisë në Shqipëri”, IPA 2013. Përfitues, MD, ZABGJ, GJ.L, PP, Gjykatat, Konferenca Gjyqësore, Komisioni Parlamentar për Reformën Ligjore, Dhoma Kombëtare e Avokatise, Dhoma Kombëtare e Noterisë.	Në proces implementimi	4, 000,000 Euro

Mbështetje strukturave të pastrimit të parave dhe hetimit të krimit financiar në Shqipëri, IPA 2013	Draftuar projektfisha	2,000,000 Euro
Projekti PAMECA IV “Konsolidimi i kapaciteteve ligjzbatuese në Shqipëri”, IPA 2013 Përfitues MPB, PSH, PP Dhe MD.	Në proces implementimi	4,000,000 Euro
Blerja e sistemit të përgjimit, IPA 2013	Draftuar projektfisha	1,000,000 Euro
Bashkëpunimi Ndërkombëtar në Drejtësinë Penale: Rrjeti i Prokurorëve në Ballkanin Perëndimor. Programi Rajonal IPA 2013 Përfitues vendet e Ballkanit Perëndimor.	Në proces implementimi	5,000,000 Euro

KREU IV

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

4.1 Monitorimi

Prokuroria Shqiptare konsideron si të një rëndësie të veçantë fazat e monitorimit dhe raportimit të realizimit në praktikë dhe punën e përditshme të kësaj strategjie afatmesme. Për këtë qëllim Prokuroria parashikon që për monitorimin në vazhdimësi të ngrihet Grupi i Punës me përbërje:

- Drejtorin e Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit;
- Drejtorin e Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale;
- Drejtorin e Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë;
- Drejtorin e Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore;
- Shefin e Sektorit të Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informativë në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Sekretarin e Përgjithshëm.

Ky Grupi Pune do të mbledhet çdo 3 muaj dhe ka përgjegjësi:

- Të ndjekë në vazhdimësi zbatimin e strategjisë në përputhje me afatet e përcaktuara në planin e veprimit të saj;
- Të raportojë për statusin e masave sipas fushës së përgjegjësisë së secilës drejtori;
- Të ndërhyjë dhe koordinojë procesin kur masat rezultojnë të pazbatuara;
- Të sigurojë harmonizimin e strategjisë me PBA-në, dhe burimet në dispozicion të planifikuara për periudhën 2015-2017.

4.2 Raportimi

Grupi i Punës do të raportojë me shkrim çdo 3 muaj tek Prokurori i Përgjithshëm duke pasqyruar progresivisht shkallën e realizimit të masave për çdo tremujor.

KREU V

PLANI I VEPRIMIT PER STRATEGJINE AFATMESME 2015-2017

Nr.	Masa	Afati kohor	Burimet financiare	Rëndësia	Treguesit e zbatimit
1. RRYTJA E EFEKTIVITETIT TË HETIMIT					
1.1	Rritja e efektivitetit dhe decentralizimi i përgjimeve - krijimi dhe funksionimi i strukturave të posaçme pranë Prokurorisë për Krime të Rënda dhe NJPH-ve; -blerja e një sistemi të avancuar të përgjimit të komunikimeve elektronike; - pajisja me mjete teknike bashkëkohore	Viti 2015-2016	Buxheti i shtetit Asistencë e huaj	Shumë e rëndësishme	Ndryshimet ligjore Ngritja e strukturave me urdher te PP Blerja e pajisjeve
1.2	Vënia në efencë dhe rritja e kapaciteteve të shërbimeve të ekspertimit - Trajnimi i stafit	Viti 2015-2017	Buxheti i shtetit Asistencë e huaj	Shumë e rëndësishme	Buxheti i Prokurorisë Trajnime të kryera

<p>1.3</p>	<p>Rritja e cilësisë së hetimit pasuror</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e bashkëpunimit ndërmjet prokurorive të rretheve gjyqësore me prokurorinë për krime të rënda; -Realizimi i analizave të posaçme mes strukturave të tjera ligjzbatuese, Prokurorisë dhe Gjykatës për Krime të Rënda; -Shfrytëzimi i teknologjisë dhe kapaciteteve hetimore-financiare të institucioneve si tatime, dogana, banka etj; -Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar; -Rritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale, nëpërmjet organizimit të trajnimeve të vazhdueshme; - caktimi i ekspertëve kontabël në mbështetje të prokurorëve dhe oficerëve të policies gjyqësore të njësisë së hetimit pasuror. - Rritja e hetimeve proactive 	<p>E vazhdueshme</p>	<p>Buxheti i shtetit Asistencë e huaj</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Raporte/analiza</p> <p>Treguesit statistikor</p> <p>Trajnime të kryera</p>
-------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------	-----------------------------------------------	----------------------------	-------------------------------------------------------------------------------

<p>1.4</p>	<p>Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i trajnimeve të përbashkëta - Shkëmbimin e shpejtë të informacionit dhe përmirësimin e cilësisë së informacioneve dhe akteve procedurale; - Realizimin e aksesit të Prokurorisë në bazat e të dhënave të institucioneve shtetërore; - Realizimin e takimeve periodike dhe analizave të përbashkëta me Policinë e Shtetit dhe institucionet që kanë një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e Njësisë të Përbashkëta Hetimore; - Raportimin e statistikave të konsoliduara dhe krijimin e historikut të hetimit e gjyqësorisë të çështjeve të korrupsionit e krimit të organizuar; - Sigurimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të policisë gjyqësore. 	<p>E vazhdueshme</p>	<p>Buxheti i shtetit Asistencë e huaj</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Trajnime të organizuara</p> <p>Raporti kallzim/regjistrim</p> <p>Memorandume të nënshkruara</p>
-------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------	-----------------------------------------------	----------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------

<p>1.5</p>	<p>Forcimi i luftës ndaj krimit kibernetik:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forcimi i kapaciteteve profesionale; trajnim i përshtatshëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, njohja me legjislacionin ndërkombëtar, shkëmbimi i eksperiencave më të mira ndërkombëtare të hetimit të krimeve kompjuterike; - Forcimi i bashkëpunimit të njësisë të luftës kundër krimit kompjuterik me strukturat e tjera shtetërore dhe ato private të cilat operojnë në fushën e teknologjisë; - Caktimi i ekspertit kibernetik; - Pajisja me infrastrukturën e duhur logjistike. 	<p>E vazhdueshme</p>	<p>Buxheti i shtetit Asistence e huaj</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Treguesit statistikor 3 mujor</p> <p>Trajnime të kryera</p> <p>Investimi përkatës</p>
<p>1.6</p>	<p>Rritja e numrit të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës mbështetëse të prokurorisë</p>	<p>2015-2017</p>	<p>Buxheti i shtetit</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Dekreti i Presidentit</p> <p>Buxheti i Prokurorisë</p>
<p>1.7</p>	<p>Përmirësimi i infrastrukturës elektronike të Prokurorisë dhe vënia në efikasitet të plotë e sistemit të “Manaxhimit të Çështjeve” (Case Management).</p>	<p>2015-2017</p>	<p>Buxheti i shtetit Asistencë e huaj</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Sistemi funksional</p>

1.8	Analiza dhe studime për ecurinë e punës në drejtim të goditjes e parandalimit të formave të ndryshme të krimit të organizuar, përcaktimin e nevojave materialo-financiare për strukturat që operojnë në këtë drejtim dhe plotësimin e tyre	E vazhdueshme	Buxheti i shtetit	I rëndësishëm	Raporte/studime
1.9	<p>Forcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore</p> <p>-Trajnimi i prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore të Krimeve të Rënda për hetimin e veprave penale të korrupsionit;</p> <p>-Hartimi i një plani 2 vjeçar trajnimi pasi të identifikohen nevojat përkatëse;</p> <p>-Krijimi i një bazë të dhënash për trajnimet që zhvillohen, stafin e trajnuar dhe materialet trajnuese;</p> <p>-Krijimi i një Reviste Shkencore, Kërkimore dhe Informative periodike të Prokurorisë.</p>	<p>E vazhdueshme</p> <p>5 maji i dytë 2015</p> <p>6 maji i dytë 2015</p> <p>2015 - 2017</p>	<p>Buxheti i shtetit</p> <p>Asistencë e huaj</p>	I rëndësishëm	<p>Trajnime të kryera</p> <p>Databaza e krijuar</p>
1.10	Forcimi i kontrollit të brendshëm dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të prokurorisë për këtë qëllim	Vazhdueshme	Buxheti i shtetit	Shumë e rëndësishme	<p>Nr. inspektimeve të kryera</p> <p>Nr. vendimeve të shfuqizuara</p> <p>Masa disiplinore</p>

2. FORCIMI I PAVARËSISË DHE ROLIT TË PROKURORIT

<p>2.1</p>	<p>Rritja dhe konsolidimi i integritetit të prokurorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i sistemit të vlerësimit të punës dhe profesionalizmit të prokurorëve; - Realizimi i vlerësimeve objektive; - Përfshirja në Sistemin e Vlerësimit të elementëve objektivë të vlerësimit të etikës dhe integritetit të prokurorit; - Zhvillimi i trajnimeve periodike vjetore mbi çështje të etikës. 				<p style="text-align: center;">Vlerësime të përfunduara</p> <p style="text-align: center;">Trajnime të kryera</p>
<p>2.2</p>	<p>Përmirësimi i statusit të prokurorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Përmirësimi i pagave dhe statusi i prokurorit; -Analizë dhe standartizim të të gjitha privilegjeve që duhet të gëzojnë prokurorët për shkak të detyrës dhe pas përfundimit të saj; 	<p>Viti 2015 -2017</p>	<p>Buxheti i shtetit</p>	<p>I rëndësishëm</p>	<p style="text-align: center;">Kadri ligjor i ndryshuar Buxheti</p>

	<p>-Përmirësimet të kushteve dhe mjediseve të punës në disa prokurori të vendit;</p> <p>-Përmirësimet të infrastrukturës elektronike të prokurorive</p>		Asistencë e huaj		Investime të kryera
2.3	Organizimi i mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve 2 herë në vit;	Vazhdueshme	Buxheti i shtetit	I rëndësishëm	
2.4	<p>Forcimi i rolit të këshillit të Prokurorisë</p> <p>Implementimi i rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Prokurorisë”, të ndryshuar;</p> <p>Zbatimi i rregullores “Për sistemin e vlerësimit të Prokurorëve”;</p> <p>Zbatimi i udhëzimit për “Procedurën e konkurrimit të kandidatëve për prokurorë që kanë punuar gjyqtarë, prokurorë apo oficerë të policisë gjyqësore” etj;</p>	2015-2017	Buxheti i shtetit	I rëndësishëm	<p>Mbledhje te kryera</p> <p>Konkurse te zhvilluara</p>

3. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

<p>3.1</p>	<p>Rritja e shpejtësisë, cilësisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar;</p> <p>-Vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta me institucionet homologe;</p> <p>-Rritjen në mënyrë të ndjeshme të shkëmbimit të informacionit me autoritetet homologe të huaja, në kuadër të procedimeve penale;</p>	<p>E vazhdueshme</p>	<p>Buxheti i shtetit</p> <p>Asistencë e huaj</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Statistika</p>
<p>3.2</p>	<p>Rritja e bashkërendimit me institucionet dhe agjencitë e huaja ligjzbatuese;</p> <p>- Ngritja e skuadrave të përbashkëta hetimore;</p> <p>-Organizimi i trajnimeve për krijimin dhe funksionimin e skuadrave të përbashkëta hetimore.</p>	<p>E vazhdueshme</p>	<p>Buxheti i shtetit</p> <p>Asistencë e huaj</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Statistika</p> <p>Numri i trajnimeve</p>
<p>3.3</p>	<p>Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar për të identifikuar, ngrirë, sekuestruar e konfiskuar asetet kriminale;</p> <p>- Organizimi i trajnimeve për njohjen me instrumentat ndërkombëtare në këtë fushë;</p> <p>- Shkëmbimin e eksperiencave më të mira;</p>	<p>E vazhdueshme</p>	<p>Buxheti i shtetit</p> <p>Asistencë e huaj</p>	<p>Shumë e rëndësishme</p>	<p>Numri i trajnimeve</p>

4. RRITJA E TRANSPARENCËS ME KOMUNIKIMIN DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

4.1	<ul style="list-style-type: none"> - Akses në informacion në përputhje me ligjin - Përditësimi i faqjes zyrtare të internetit të prokurorisë me aktivitetet më të fundit të kryera - Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me mediat, etj; 	E vazhdueshme	Buxheti i shtetit Asistencë e huaj	E rëndësishme	Kërkesa për informacion të trajtuara ëbsite i përditësuar
4.2	Fushatë ndërgjegjëse mediatike për fenomenin e korrupsionit, krimin e organizuar, narkotikët, rekrutimet në Siri, etj;	E vazhdueshme	Buxheti i shtetit Asistencë e huaj	E rëndësishme	
4.3	<p>Fushatë ndërgjegjëse me studentët e Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Ekonomisë (publike dhe private).</p> <ul style="list-style-type: none"> -Leksione të hapura periodike (marrëveshje bashkëpunimi me rektoratin ose dekanatet); -Konkurse mbi tema të ndryshme në fushën e korrupsionit dhe krimin të organizuar; -Në bashkëpunim me Fakultetet e Drejtësisë, përfshirja e studentëve në realizimin e studimeve të ndryshme, në interes të Prokurorisë së Përgjithshme. 	E vazhdueshme	Buxheti i shtetit Asistencë e huaj	E rëndësishme	Leksione të mbajtura Konkurse të zhvilluara